



Universiteti “Kadri Zeka” Gjilan
Fakulteti i Edukimit

ANALIZA E TEKSTEVE MËSIMORE NGA KLASA 1 DERI 5 TË CILAT
NXISIN ZHVILLIMIN E MENDIMIT KRITIK TË NXËNËSVE

Mensur Neziri

mensur.neziri@uni-gjilan.net

Rëndësia e studimit

- Studimi ka të bëjë me identifikimin e fakteve kurrikulare që nxisin zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve të shkollës fillore në Kosovë.
- Ky studim u tregon autorëve të teksteve mësimore se, cilat janë mundësitë që ata kanë krijuar në tekstet e tyre për zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve.
- Ky studim është i një rëndësie të veçantë, pasi u tregon mësimdhënësve të shkollës fillore në Kosovë se sa i përdorin ata mundësitë që ofrojnë tekstet për zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve dhe se sa mundësi praktike ata krijojnë që duke pasur për pikënisje tekstet të përdorin edhe metodologjitë efektive të organizimit të një mësimdhënieje, e cila nxitë zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve.
- Rëndësia e këtij studimi është gjithashtu në faktin se ai duke vëzhguar një sasi të caktuar orësh mësimore në shkollën fillore, ofron një paraqitje të qartë të realitetit të klasës mësimore dhe të aktiviteteve që kryhen aty dhe të cilat mundësojnë ose jo një mbështetje të zhvillimit të mendimit kritik të nxënësve.

Qëllimi dhe objektivat e studimit

3

- Qëllimi i këtij studimi është të eksplorojë dhe të masë se deri në çfarë mase tekstet, kompetenca e mësimitdhënësit dhe aktivitetet mësimore në klasë krijojnë mundësi për zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve të shkollës fillore në Kosovë dhe të bëjë rekomandimet përkatëse.
 1. Objektivi i parë ka të bëjë me matjen e sasisë së fakteve që përmbahen në tekstet shkollore të klasave I-V të Kosovës dhe vlerësimin e mundësive që ato fakte japin për zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve;
 2. Objektivi i dytë ka të bëjë me matjen e përpjekjeve të mësimitdhënësve për përdorimin e mundësive të fakteve ekzistuese dhe krijimin e mundësive të reja për zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve gjatë orëve të mësimi;
 3. Objektivi i tretë është matja e përfshirjes së nxënësve në aktivitete mësimore me fokus në zhvillimin e mendimit kritik të tyre.

Metodat e hulumtimit

4

Dizajni i këtij hulumtimi është kryer sipas kombinimit të tri metodave kryesore:

1. Analizës së përmbajtjes;
2. Intervistimit të mësimdhënësve;
3. Vëzhgimi i aktiviteteve në orët mësimore.

Duke krahasuar rezultatet nga analiza e përmbajtjes (skeda) nga intervistimi i mësimdhënësve dhe vëzhgimi në orët mësimore mund të arrijmë në disa përfundime të dobishme, si për hartuesit e kurrikulave ashtu edhe për zbatuesit e tyre.

Instrumentet e studimit

5

- Skeda për matjen e mundësive të teksteve për ZHMK - është një matricë për skanimin e teksteve. Ajo bazohet në skedën e Raportit Delphi. Kjo skedë përmban gjashtë dimensione për zhvillimin e mendimit kritik. Këto dimensione janë: interpretimi, analiza, vlerësimi, konkludimi, shpjegimi dhe vetrregullimi. Për qëllimet e studimit më është dashur që ta modifikoj këtë skedë. Modifikimi i kryer është mbështetur në qëllimet e ndryshme për të cilat është përdorur kjo skedë në Raportin Delphi. Në Raportin Delphi kjo skedë është përdorur për të matur mundësitë e zhvillimit të mendimit kritik në diskutime verbale, ndërsa në studimin tim është përdorur për të matur mundësi për zhvillimin e mendimit kritik në tekst të shkruar. Dimensionin e përjashtuar në skedën time është vetrregullimi. Më poshtë do të përshkruaj se çfarë kuptimi ka secili prej këtyre dimensioneve.

Skeda për vlerësimin e mundësive të teksteve për zhmk të nxënësve

6

Grupet e mundësive	Operacionet për zhvillimin e mendimit kritik	Treguesit e mundësive për zhmk	Teksti X				
			Mësimi 1	Mësimi 2	Mësimi 3	Mësimi 4	MN
Interpretimi	Kategorizimi						
	Qartësia						
	Pasuria shprehëse						
Analiza	Shtjellimi i ideve						
	Argumentimi i qartë						
	Argumente të dallueshme						
Vlerësimi	Dallimi i besueshmërisë						
	Krahasimi i argumenteve						
Konkludimi	Informacione të lidhura						
	Shpjegime alternative						
	Prania e konkluzioneve						
Shpjegimi	Shprehja e përfundimeve						
	Operacionet						
	Argumentimi i përfundimeve						

Kuptimi i dimensioneve për zhmk

7

- **Interpretimi** ka të bëjë me kuptueshmërinë e një teksti të shkruar. Që një tekst të jetë i kuptueshëm faktet e paraqitura në të kërkohet të jepen të kategorizuara, të përshkruhen me qartësi dhe të shprehen duke përdorur një gjuhë të qartë.
- **Analiza** ka të bëjë me zbulimin e lidhjeve midis fakteve të tekstit të shkruar. Që një tekst të mundësojë analizë faktet e paraqitura në të duhet të jenë të shtjelluara, argumentet të paraqitura qartë dhe të jenë të dallueshme.
- **Vlerësimi** ka të bëjë me mundësinë që informacionet të jenë të besueshme dhe argumentet e përdorura të jenë të krahasueshme.
- **Konkludimi** ka të bëjë me prezencën dhe paraqitjen e informacioneve të lidhura me njëra-tjetrën, me dhënien e shpjegimeve të mundshme alternative dhe me prezencën e përfundimeve.
- **Shpjegimi** ka të bëjë me shprehjen dhe argumentimin e përfundimeve.

Kartelë vëzhgimi për vlerësimin e dimensioneve të zhvillimit të mendimit kritik në orën mësimore

8

Nr.	Dimensione të të menduarit kritik	Shkalla matëse e mendimit kritik				
1	Kupton dhe shpreh qartë mendimin e tjetrit.	1	2	3	4	5
2	Shpreh mendimin e tij.	1	2	3	4	5
3	Merr parasysh mendimet e të tjerëve.	1	2	3	4	5
4	Analizon vlefshmërinë e hipotezave.	1	2	3	4	5
5	Vlerëson cilësinë e të dhënave.	1	2	3	4	5
6	Paraqet ide.	1	2	3	4	5
7	Ndjek diskutimin.	1	2	3	4	5
8	Përqendrohet në çështje.	1	2	3	4	5

Kampioni dhe kampionimi

- Popullacionin e këtij problemi e përbëjnë tekstet e ciklit fillor I - V
- Ne kemi analiza e përmbajtjet kurrikulare (teksteve) që nxisin zhvillimin e mendimit kritik, për 6 tekste të ndryshme nga klasa 1 – 5 si: Leximi 1 – 5, Gjuha Shqipe 1 – 5, Edukata Qytetare 3 – 5, Historia 5, Art figurativ 1 – 5 dhe Edukata Muzikore 1 – 5, gjithsej 24 tekste të ciklit fillor.
- Intervistimi i 336 mësimdhënsve në 24 shkolla në 6 (gjashtë) rajonet e Kosovës: Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Ferizaj dhe Gjilan. Në secilin rajon kemi marrë opinionet e 56 mësimdhënësve të të dyja mjediseve urbane dhe rurale.
- Vëzhgimi i 336 orët mësimore për lëndët: Leximi 1 – 5, Gjuha Shqipe 1 – 5, Edukata Qytetare 3 – 5, Historia 5, Arti figurativ 1 – 5 dhe Edukata Muzikore 1 – 5.

Të gjeturat nga tekstet

10

Teksti	Interpretimi	Analiza	Vlerësimi	Konkludimi	Shpjegimi	Shuma
Leximi I – V	369	384	225	299	306	1,583
Gjuhë shqipe I – V	259	287	192	256	304	1,298
Edukata qytetare III – V	189	244	161	237	267	1,098
Historia V	87	70	29	59	64	309
Arti figurativ I – V	262	387	213	271	266	1,399
Edukata muzikore I – V	145	162	99	168	185	759

Rezultatet

11

- Leximit 1-5 kemi tri gjetje:
 1. Dimensioni më i shfaqur për zhvillimin e mendimit kritik është ai i analizës (vlera 384). Ndërsa operacioni më i vlerësuar në këto tekste është kategorizimi (vlera 225).
 2. Gjetja e dytë vjen nga të dhënat e grumbulluara nëpërmjet anketimit të mësuesve. Sipas kësaj analize dimensioni më i shfaqur për zhvillimin e mendimit kritik është po ai i analizës. (vlera 215).
 3. Gjetja e tretë vjen nga të dhënat e grumbulluara nëpërmjet vëzhgimit të orëve të mësimit në lëndën leximi 1 - 5 (elementi i tretë i metodologjisë). Sipas kësaj analize moda (apo mediana), pra vlera më e përhapur në shkallën me pesë nivele (ose vlera që e ndan më dysh shpërndarjen e vlerësimeve, nëse është mediana) është 4, pra një nivel relativisht i lartë kënaqshmërie nga krijimi i mundësive që ora e mësimit të krijojë mundësi për përdorimin dhe zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve.

Rezultatet

12

- Gjuha shqipe 1-5 kemi tri gjetje:
 1. Dimensioni më i shfaqur për zhvillimin e mendimit kritik është ai i shpjegimit. (vlera 304). Ndërsa operacioni më i vlerësuar në këto tekste është pasuria shprehëse. (vlera 112).
 2. Gjetja e dytë vjen nga të dhënat e grumbulluara nëpërmjet anketimit të mësuesve. Sipas kësaj analize dimensionit më i shfaqur për zhvillimin e mendimit kritik është po ai i shpjegimit. (vlera 217).
 3. Gjetja e tretë vjen nga të dhënat e grumbulluara nëpërmjet vëzhgimit të orëve të mësimit në lëndën gjuha shqipe 1 - 5 (elementi i tretë i metodologjisë). Sipas kësaj analize moda (apo mediana), pra vlera më e përhapur në shkallën me pesë nivele (ose vlera që e ndan më dysh shpërndarjen e vlerësimeve, nëse është mediana) është 4, pra një nivel relativisht i lartë kënaqshmërie nga krijimi i mundësive që ora e mësimit të krijojë mundësi për përdorimin dhe zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve.

Rezultatet

13

- Edukata qytetare 3 – 5 kemi tri gjetje:
 1. Dimensioni më i shfaqur për zhvillimin e mendimit kritik është ai i shpjegimit. (vlera 267). Ndërsa operacioni më i vlerësuar në këto tekste është shprehja e përfundimeve. (vlera 93).
 2. Gjetja e dytë vjen nga të dhënat e grumbulluara nëpërmjet anketimit të mësuesve. Sipas kësaj analize dimensioni më i shfaqur për zhvillimin e mendimit kritik është po ai shpjegimit. (vlera 126).
 3. Gjetja e tretë vjen nga të dhënat e grumbulluara nëpërmjet vëzhgimit të orëve të mësimit në lëndën edukata qytetare 3 - 5 (elementi i tretë i metodologjisë). Sipas kësaj analize moda (apo mediana), pra vlera më e përhapur në shkallën me pesë nivele (ose vlera që e ndan më dysh shpërndarjen e vlerësimeve, nëse është mediana) është 4, pra një nivel relativisht i lartë kënaqshmërie nga krijimi i mundësive që ora e mësimit të krijojë mundësi për përdorimin dhe zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve.

Rezultatet

14

- Historia 5 kemi tri gjetje:
 1. Dimensioni më i shfaqur për zhvillimin e mendimit kritik është ai i interpretimit. (vlera 87). Ndërsa operacioni më i vlerësuar në këto tekste është shprehja e përfundimeve. (vlera 30).
 2. Gjetja e dytë vjen nga të dhënat e grumbulluara nëpërmjet anketimit të mësuesve. Sipas kësaj analize dimensioni më i shfaqur për zhvillimin e mendimit kritik është po ai interpretimit (vlera 42).
 3. Gjetja e tretë vjen nga të dhënat e grumbulluara nëpërmjet vëzhgimit të orëve të mësimit në lëndën Historia 5 (elementi i tretë i metodologjisë). Sipas kësaj analize moda (apo mediana), pra vlera më e përhapur në shkallën me pesë nivele (ose vlera që e ndan më dysh shpërndarjen e vlerësimeve, nëse është mediana) është 4, pra një nivel relativisht i lartë kënaqshmërie nga krijimi i mundësive që ora e mësimit të krijojë mundësi për përdorimin dhe zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve.

Rezultatet

15

- Edukata muzikore 1 - 5 kemi tri gjetje:
 1. Dimensioni më i shfaqur për zhvillimin e mendimit kritik është ai i shpjegimit. (vlera 185). Ndërsa operacioni më i vlerësuar në këto tekste është argumentimi i përfundimeve (vlera 67).
 2. Gjetja e dytë vjen nga të dhënat e grumbulluara nëpërmjet anketimit të mësuesve. Sipas kësaj analize dimension i më i shfaqur për zhvillimin e mendimit kritik është ai konkludimit dhe interpretimit (vlera 210).
 3. Gjetja e tretë vjen nga të dhënat e grumbulluara nëpërmjet vëzhgimit të orëve të mësimit në lëndën Historia 5 (elementi i tretë i metodologjisë). Sipas kësaj analize moda (apo mediana), pra vlera më e përhapur në shkallën me pesë nivele (ose vlera që e ndan më dysh shpërndarjen e vlerësimeve, nëse është mediana) është 4, pra një nivel relativisht i lartë kënaqshmërie nga krijimi i mundësive që ora e mësimit të krijojë mundësi për përdorimin dhe zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve.

Rezultatet

16

- Art figurative kemi tri gjetje:
 1. Dimensioni më i shfaqur për zhvillimin e mendimit kritik është ai i analizës. (vlera 387). Ndërsa operacioni më i vlerësuar në këto tekste është argumentimi i qartë. (vlera 143).
 2. Gjetja e dytë vjen nga të dhënat e grumbulluara nëpërmjet anketimit të mësuesve. Sipas kësaj analize dimensioni më i shfaqur për zhvillimin e mendimit kritik është po ai i interpretimit (vlera 211).
 3. Gjetja e tretë vjen nga të dhënat e grumbulluara nëpërmjet vëzhgimit të orëve të mësimit në lëndët përkatëse. Sipas kësaj analize moda (apo mediana), pra vlera më e përhapur në shkallën me pesë nivele (ose vlera që e ndan më dysh shpërndarjen e vlerësimeve, nëse është mediana) është 3, pra një nivel mesatar relativisht i kënaqshëm që ora e mësimit të krijojë mundësi për përdorimin dhe zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve.

REKOMANDIME

17

- Kompetenca e zhvillimit të mendimit kritik të përfshihet edhe në tekstin për standardet shkollore;
- Hartuesit e kurrikulave të plotësojnë edhe më tej dimensionin e vlerësimit në tekstet shkollore;
- MASHT të zhvilloj trajnime, të cilat ndihmojnë mësuesin në identifikimin e lehtë të dimensioneve të caktuara që nxisin zhvillimin e mendimit kritik, për t'u familiarizuar me metodologjitë bashkëkohore të mësimit.
- Përshtatja e programit kurrikular nevojave të nxënësit.

Literatura

- Bradley, L. H. (1993). Total Quality Management for Schools. Mancaster: Technomic Publishing.
- Coladarci, Th & Cobb, C.D. (2004). Fundamentals of Statistical Reasoning in Education. Fourth Edition.
- Facione, P. A. (1990). The Delphi Raport: Critical Thinking. California: The California Academic Press.
- Fraenkel, J.R & Wallen, N.E. (2008). How to Desing and Evaluate Research in Education. Seventh Edition,. McGraw-Hill.
- Gav, L.R Mills & G.E, & Airasian, P. (2006). Educational Research. Competencies for Analsisand Applications.
- Hendrick, J. (1992). The Whole Child, Engly Wood Cliffs, NJ: Merrill.
- Karaj, T. (2005). Psikologji e zhvillimit të fëmijës, Second edition. Tirana: Progress.
- Komani, P. (2004). Pamje të teorive për zhvillimin e fëmijëve. Tirana: The Institute of Pedagogical Studies.
- MEST. (2011). Standarde për tekstet shkollore. Prishtina: MEST.
- Ornstein, A. C. (1986). Curriculum, Instruction and Supervision. NewYork: NASSP Bulletin.

PYETJE & KOMENTE

Faleminderit!